



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina
SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT



Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Shar Morina” B.I. të datës 23.05.2023 të cilës i janë bashkangjitur sqarimet shtesë me titull “Kërkesë për rivlerësim” të dt. 31.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 23.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shpenzimet e tjera kontraktuese – Detektor për monedha falco (jo korrekte) për monedha të metalit dhe të letrës” me nr. të prokurimit 616-23-4390-1-3-6, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Shar Morina” B.I. e datës 23.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 23.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shpenzimet e tjera kontraktuese-Detektor per monedha falco (jo korrekte)per monedha te metalit dhe te letrës” me nr. të prokurimit 616-23-4390-1-3-6ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 23.05.2023 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në rivlerësim aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik “Shar Morina” B.I. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Shar Morina” B.I. (tutje “parashtruesi”) me datë 23.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 23.05.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shpenzimet e tjera kontraktuese-Detektor per monedha falco (jo korrekte)per monedha te metalit dhe te letrës” me nr. të prokurimit 616-23-4390-1-3-6

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim.

1. **Pretendimi i parë:** *“Kompania ka ofertuar pozicioni 1 – detektor për detektimin e kartmonedhave modelin DP-2268 i cili është prodhim i kompanisë Shenzhen Double Power Electronics Co.Ltd. Për këtë pajisje operatori ekonomik nuk posedon autorizim nga prodhuesi”.*
2. **Pretendimi i dytë:** *“Pozicioni 1 – Sipas kërkesës teknike Sortimi për cope, sortimi në baze të vlerave, sortimi sipas anës së kartmonedhave – kjo pajisje nuk e posedon këtë funksion... Në këtë rast është ofertuar një pajisje e cila i pranon banknotat një nga një dhe rrjedhimisht nuk ka mundësi teknike të realizohet sortimi”.*
3. **Pretendimi i tretë:** *“Pozicioni 1 – Në kërkesat teknike është kërkuar që pajisja të jetë e pajisur me opsionin e numerimit dhe detektimit të valutes CHF. Në broshurën teknike të dorëzuar nuk ceket që kjo pajisje përfshin numerimin dhe detektimin e valutes CHF”.*
4. **Pretendimi i katërt:** *“Sa i përket autorizimit për pozicionin e dytë – makine për numerimin dhe verifikimin e parave hekur (monedha) duhet të cekim se autorizimi mban datën 22.05.2023 pra pas datës së përfundimit të dorëzimit të tenderit që ishte data 15.05.2023... Për më tepër nuk është i drejtë nga prodhuesi ashtu siç kërkohet nga kërkesat e pershtatshmerisë”.*
5. **Pretendimi i pestë:** *“Në ofertën financiare, pozicionet 3, 4, 6 kanë gabime aritmetike”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje “RRPP”), autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 05.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim. Pas analizimit të pretendimeve të parashtruesit është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë të bazuara në kuptim të nenit 63 paragrafit 63.1. nën paragrafi 63.1.2. të RRPP.

Sa i përket pretendimeve të parashtruesit janë administruar si prova materiale të gjitha dokumentet relevante në këtë aktivitet të prokurimit ashtu që është gjetur se tenderuesi i rekomanduar në këtë rast nuk posedon dokumentet sipas dosjes së tenderit në përputhje me pretendimin e parë dhe të dytë të parashtruesit. Tutje është vërtetuar edhe pretendimi i tretë i parashtruesit lidhur me pajisjen në fjalë. Po ashtu është konfirmuar edhe

pretendimi i katërt dhe i pestë i parashtruesit lidhur me autorizimin e tenderuesit të rekomanduar si dhe ofertën financiare të tij.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara lidhur me këtë kërkesë për rishqyrtim është konfirmuar se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të bazuara. Për këto arsye është miratuar si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.06.2023



Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimin të këtij vendimi.